



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:226978  
Datë: 04.05.2023  
Numri i dokumentit: 04251761  
Dosja fizike: C-IV-14-6670

Q A nga Fshati S e E, Komuna e Vitisë.

*Paditësi*

Kundër:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë

*E paditura*

**DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT** (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Mr.sc. Bajram Miftari, me datën 04.05.2023, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Q A ashtu që VËRTETOHET vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit GJI035-0257, i datës 01.10.2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**Rrethanat procedurale të çështjes**

Me datën 22.10.2022, paditësi ka paraqitur ankesë pranë Dhomës së Posaçme, kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), me të cilën e ka atakuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL), GJI035-0257, të datës 01.10.2014.

Pala paditëse e ka titulluar parashtresën si “*ankesë*”, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi, konform nenit 35.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pran Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Pala paditëse në padi ndër të tjera ka theksuar: Pranë Autoriteti të Likuidimit ka parashtruar kërkesë kreditore për përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e shumës prej 600.00 €, në emër të kompensimit në formë të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes para kohe të marrëdhënie

së punës në NSH “N.B.I Agromorava”. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar dhe me vendimin e kontestuar kërkesën e parashtruar e ka refuzuar si të pa bazuar. Vendimin e AL-së e ka kundërshtuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale; vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe aplikim të gabuar të dispozitave materiale juridike. Më tutje, ka theksuar se ka qenë punëtor i NSH-së dhe në bazë të njoftimit të lëshuar nga pala e paditur me datën 25.11.2005, i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe se në njoftim është theksuar se shumata e pagave do të realizohen në procedurën e likuidimit. Duke vepruar në përputhje me njoftimin e palës së paditur e ka parashtruar kërkesën kreditore brenda afatit për dorëzimin e kërkesave, mirëpo AL kërkesën e parashtruar e ka refuzuar. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta miratojë si të bazuar dhe të obligohet pala e paditur që t’ia kompensojë shumën prej 600.00 €, në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në ndërmarrje. Bashkëngjitur me padinë, e ka dorëzuar vendimin e AL-së, GJI035-0257.

Me datën 10.03.2022, e paditura ka paraqitur përgjigje në padi, ku ndër të tjera ka theksuar: Objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL-së, respektivisht përputhshmëria e tij me Ligjin 04/L-034, për AKP-në. Me nenin 74.2 të atij ligji është përcaktuar se ankesat e dorëzuara në Dhomën e Posaçme kundër vendimeve të AL, duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034. Paditësja nuk ka sqaruar se cila dispozitë ligjore është shkelur nga ana e AL me rastin e vendosjes në kërkesën e tij. Me tutje ka theksuar se kërkesa kreditore e parashtruar nga pala paditëse është e pa bazuar për faktin se kërkesa është e parashkruar bazuar në nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Kjo për faktin se pala paditëse nuk i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent për realizimin e kërkesës nga viti 2008. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta refuzoj dhe ta vërtetojë vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

### **Gjendja faktike e konstatuar**

Me nenin 8.1 të LPK- së është përcaktuar: *“Se cilat fakte do t’i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit. Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku”*.

Me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata iu është referuar fakteve të prezantuara nga palët në procedurë dhe provave të bashkëngjitura nga palët në procedurë.

Pala paditëse ka dorëzuar prova: listën e përfundimtare të përfituesve të 20%-it; procesverbalin e datës 15.04.2011; dhe njoftimin e datës 25.11.2005. Ndërsa e paditura nuk ka dorëzuar ndonjë provë.

Në këtë çështje juridike, gjykata ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha parashtrimet e palëve në procedurë dhe ka shqyrtuar provat e lëndës sipas rregullave që përcakton neni 8 i LPK-së dhe dispozitat e tjera procedurale të ndërlidhura.

- Në vlerësimin e kësaj çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundimin se pala paditëse ka parashtruar kërkesë pranë AL-së me të cilën ka kërkuar kompensimin e shumë prej 600.00 €, në emër të kompensimit në formë të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në NSH. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën dhe me vendimin me numër GJI035-0257, të datës 01.10.2014, e ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar. Paditësi me padi e ka kontestuar vendimin në fjalë duke pretenduar se AL nuk ia ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore dhe ka pretenduar se kërkesa e tij gjen mbështetje ligjore, mirëpo nuk ka parashtruar prova për të vërtetuar pretendimet e dhëna me padi. Nga ana tjetër, pala e paditur e ka kontestuar kërkesëpadinë me arsyetimin se e njëjta është e pa vlefshme.
- Gjykata me datën 11.10.2022, ka lëshuar urdhër për palën paditëse ku ndër të tjera i ka kërkuar të ofroj prova për ta mbështetura kërkesëpadinë respektivisht të ofroj prova se kur e ka themeluar marrëdhënien e punës, sa vite përvojë pune i kishte në vitin 2005, dhe sa ishte paga mujore e tij gjatë vitit 2005. Nga shkresat e lëndës rrjedh se pala paditëse e ka pranuar urdhrin e gjykatës me datën 17.10.2022. Megjithatë, paditësi nuk është përgjigjur në urdhrin e gjykatës, e rrjedhimisht pretendimet e tij kanë mbetur të pa provuara.

### **Arsyetimi ligjor**

Procedura gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar me Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 06/L-086, i publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 12/27, Qershor 2019), si ligj special. Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se *“në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”*.

Ligji për Dhomën e Posaçme, neni 74, i jep të drejtën palës (kreditorit në procedurë të likuidimit) që të ushtroj mjetin juridik - ankesën kundër vendimit të AL-së, pranë Dhomës së Posaçme. Sipas të njëjtës dispozite ligjore, Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë aktgjykim për vërtetimin, shfuqizimin apo ndryshimin e vendimit të AL-së, varësisht prej epilogut të procesit gjyqësor dhe në zbatim të dispozitave ligjore të aplikueshme.

Gjykata fillimisht ka shqyrtuar se a është e nevojshme mbajtja e seancës dëgjimore me palët në procedurë apo çështja mund të vendoset në bazë të materialeve në lëndë. Këtë çështje nuk e adreson Ligji për Dhomën e Posaçme si ligj special, por vetëm LPK si ligj procedural i përgjithshëm. Me LPK, neni 4, është përcaktuar se:

- Neni 4.1: Gjykata vendos për kërkesëpadinë pas shqyrtimit të çështjes juridike në seancë të drejtpërdrejtë dhe publike.
- Neni 4.2: Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj.

Një rast të tillë të përcaktuar me të njëjtin ligj ku mund të merret vendim meritator pa pasur nevojë që të mbahet seancë dëgjimore, e kemi të rregulluar me nenin 399 të LPK-së, ku është përcaktuar si në vijim:

- Neni 399.1: Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritator me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija.
- Neni 399.2: Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.

Gjykata, pas shqyrtimit të dosjes së lëndës ka ardhur në përfundimin se nga faktet e treguara apo të prezantuara nga pala paditëse në padi, nuk del themelësia e kërkesëpadiës. Përkundrazi, mbi bazën e të gjitha fakteve siç i ka prezantuar pala paditëse në padi rezulton se kërkesëpadija nuk është e bazuar. Prandaj, edhe janë plotësuar kushtet ligjore për të zbatuar nenin 399 të LPK-së.

Vendimi i AL-së i atakuar me padi, pohon se paditësi nuk e ka justifikuar shumën e kërkuar prej 600.00 €. Prandaj, “barra e të provuarit” i ka takuar palës paditëse që të dëshmojë faktet mbi të cilat e bazon kërkesën e saj. Sipas vlerësimit të gjykatës, pala paditëse nuk e ka mbështetur kërkesën e saj në fakte dhe prova konkrete.

Gjykata tërheqë vëmendjen më tutje se me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 31 (Obligimet e palëve në procedurë), është përcaktuar:

*Palët, në parashtrirat e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës. Dhoma e Posaçme sipas detyrës zyrtare bën hetimin e fakteve vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Dhoma e Posaçme duhet t'i inkurajojë palët që të arrijnë zgjidhje me negociata para dhe gjatë cilësdo procedurë. Në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore, palët veprojnë në mënyrë të singertë. Secila palë, në parashtrirat e saj me shkrim, duhet të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi”.*

Pastaj, me nenin 42, paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, është përcaktuar se

*Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese). Secilës palë tjetër do t'i jepet mundësia e arsyeshme për ta kontestuar legjitimitetin apo saktësinë e provave të tilla, nëpërmjet paraqitjes së parashtrësave apo provave tjera (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) ... Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.*

Edhe me nenin 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është përcaktuar se palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

Konform këtyre dispozitave ligjore të cituara më sipër, rezulton se ka qenë në përgjegjësinë ligjore të palës paditëse që të argumentoj pretendimin e saj se për cilat arsye i takon e drejta në dëmshpërblim nga ndërprerja e marrëdhënies së punës, mirëpo paditësi ka dështuar që të ofroj argumentet faktike dhe ligjore në mbështetje të kërkesës së tij, qoftë me padinë e parashtruar qoftë me ndonjë parashtrësë të mëvonshme.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë përmendura dhe në zbatim të dispozitave ligjore të cituara më sipër, gjykata ka ardhur në përfundimin se janë përmbushë kushtet ligjore për të nxjerrë vendim meritorë (aktgjykim) në këtë fazë të procedurës shkresore dhe se seanca mbajtja e seancës dëgjimore në këtë rast, është e panevojshme.

Pas një procesi të vlerësimit ligjor të fakteve të prezantuara nga palët në procedurë dhe shqyrtimit të të gjitha provave materiale të ofruara prej tyre, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia nuk është e bazuar në ligj.

Gjykata potencon se kompensimi në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në Ndërmarrje është rregulluar në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP, mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2, ku është janë përcaktuar si kategori e veçantë “kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga agjencia, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në”. Nga këto dispozita është e përcaktuar se punëtori gëzon të drejtën për dëmshpërblim, “nëse punëtori ka qenë duke punuar në vendin e punës, kur Bordi i AKP-së, ka marr vendimin për fillimin e procedurës së likuidimit dhe nëse vërtetohet se punëtorit nuk ju janë paguar pagat”. Pastaj, me nenin 76.7 të Ligjit të Punës është përcaktuar se lartësia e dëmshpërblimit që i takon punëtorit si pasojë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, varet nga kohëzgjatja e stazhit të punës së punëtorit dhe nga lartësia e pagës mujore të tij. Paditësi është dashur të ofroj dëshmi të kësaj natyre, qysh me kërkesën kreditore të drejtuar AL-së, pastaj edhe me padi. Gjykata i ka dhënë edhe një mundësi shitesë për dorëzim provash, përmes urdhrin të posaçëm me shkrim dhe paditësi përsëri ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tij procedurale. Rrjedhimisht, paditësi ka dështuar që të provoj faktet vendimtare të rastit, se sa ishte

paga mujore e tij, sa vite stazh pune kishte dhe sa do të duhej të ishte kompensimi për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Në mungesë të këtyre të dhënave dhe dëshmive, ka qenë e pa mundur që të konstatohet se kishte dëm, që të matet lartësia e dëmit, dhe të konstatohet se sa ishte lartësia e pagave që do t'i takonin paditësit, si kritere për zbatimin e dëmshpërblimit adekuat nga ndërprerja e marrëdhënies së punës.

Në urdhrin e dt. 11.10.2022, i është tërhequr vëmendja paditësit se *“pas përfundimit të procedurave me shkrim, gjykata do të vendos nëse do të mbajë seancë dëgjimore me palët në procedurë apo rastin ta vendos pa mbajtjen e seancës dëgjimore, varësisht nga specifikat e lëndës dhe në zbatim të dispozitave ligjore të aplikueshme”*. Pasi është konstatuar se paditësi në vazhdimësi ka dështuar që të dorëzojë prova në mbrojtje të rastit të tij, gjykata ka ardhur në përfundimin se janë plotësuar kushtet ligjore për të marrë vendimin merititor.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë cekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia është e pabazuar, ndaj, të njëjtën e ka refuzuar në tërësi.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ku është përcaktuar se *“Nëse pala e suksesshme nuk i kërkon shpenzimet ose nëse ashtu vendos Dhoma e Posaçme, atëherë secila palë i bartë shpenzimet e veta”*. Në këtë rast gjyqësor, asnjëra nga palët në procedurë nuk ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale. Prandaj, gjykata ka vendosur që secila palë do të bartë shpenzimet e veta.

### **Udhëzimi juridik**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim pranë Dhomës së Posaçme, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të tij, e cila i drejtohet Kolegjit të Apelit pranë Dhomës së Posaçme, konform nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Gjyqtari,**  
**Mr.sc. Bajram Miftari**